



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



REPUBLIKA E ALBANI
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË



ISHMT
Instituti Shqiptar i Teknologjisë dhe Tregut
info@ishmt.gov.al
www.ishmt.gov.al

BULETIN INFORMATIV

*Siguria e produkteve
Pronësia intelektuale*



PARATHËNIE

Buletini informativ është një botim i realizuar nga Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut (ISHMT) me mbështetjen e GIZ në kuadrin e projektit “Harmonizim i Legjislacionit ekonomik dhe tregtar me acquis e BE-së”.

Inpektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut është institucion shtetëror i ngritur në bazë të VKM nr. 36, datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”. Ai ka për detyrë kontrollin dhe garantimin e sigurisë së produkteve jo-ushqimore që hidhen në treg për konsumatorët.

Nëpërmjet këtij buletini informativ synohet :

- Të ofrohet informacion mbi detyrat dhe përgjegjësitë e operatorëve ekonomik për të garantuar sigurinë e produkteve jo-ushqimore që vendosen në treg.
- Njohja e ISHMT-së nga të gjithë operatorët ekonomikë, konsumatorët, institucionet shtetërore, organizatat profesionale, OJF-të, etj.
- Ndërgjegjësimi i konsumatorëve mbi të drejtat e tyre, përmes njohjes së drejtpërdrejtë të detyrimeve që duhet të përmbushin operatorët ekonomikë dhe të standardeve të produkteve jo-ushqimore, me qëllim ofrimin në treg të produkteve/pajisjeve/instalimeve të sigurta, sipas kërkesave ligjore.

Për më shumë informacion mund të vizitoni faqen tonë www.ishmt.gov.al ose mund të na kontaktoni në adresën info@ishmt.gov.al

STAFI I ISHMT-SË



SIGURIA E

INSTRUMENTET MATËS LIGJËRISHT TË KONTROLLUAR

PARAPAKETIMI

LODRAT

DETERGJENTËT


VESHJET E KËMBËS

QELQI


TEKSTILET

PRODUKTET ELEKTRIKE

ASHENSORËT



PRODUKTEVE





INSTRUMENTET
MATËS LIGJËRISHT
TË KONTROLLUARA

I. INSTRUMENTET MATËS LIGJËRISHT TË KONTROLLUAR

A. Detyrimet e prodhuesve dhe importuesve të instrumentëve matëse

Prodhuesit ose Importuesit e instrumentëve matës ligjërisht të kontrolluar janë të detyruar që të hedhin në treg vetëm ato instrumente që:

- Kanë shenjën e markimit CE, Markimit Metrologjik Suplementar M, me dy numrat e fundit të vitit të prodhimit; Markimi Metrologjik Suplementar M, dy numrat e fundit të vitit të prodhimit;
- Kanë Deklaratën e Konformitetit EC, që është në formatin e kërkuar në përputhje me ligjin 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e produkteve joushqimore” dhe VKM nr. 770 datë 02.11.2016 “Rregullorja për instrumentet matës”
- Instrumentat matës që nuk janë objekt i markimit CE, përcaktohen në rregulloren e nxjerrë nga Ministri për Ekonominë dhe për t’u vendosur në treg kërkojnë miratimin e tipit dhe verifikimin fillestar;
- Kanë kaluar procedurat e përshkruara të vlerësimit të konformitetit;
- Janë në përputhje me rregullat dhe kërkesat metrologjike;
- Kanë shenjat e përputhjes së prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar, i cili garanton që instrumene matës përputhen me kërkesat metrologjike të përshkruara;
- Janë të testura sipas një procedure të përshkruar;
- Kanë shenjat verifikuese të përshkruara.

(Neni 19, i Ligjit nr. 9875 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar dhe VKM, nr. 770, datë 2.11.2016 “Rregullore për Instrumentat matës”)

Prodhuesit ose importuesit e instrumentave matës kanë detyrimin dhe përgjegjësinë ligjore:

- Të vendosin në treg instrumene matës me Markim CE, Markimin Metrologjik Suplementar ku të jepet dhe viti i prodhimit të tyre, nëpërmjet 2 numrave të fundit;
- Të kryejnë verifikimin fillestar nëse instrumenti matës nuk e ka kaluar këtë kontroll;
- Të kryejnë miratimin e tipit të instrumentit matës, për ata instrumenta matës ligjërisht të kontrolluar që nuk janë objekt i markimit CE, sipas rregullores së nxjerrë nga Ministria e Ekonomisë;
- Të mbajnë për 10 vjet Deklaratën e Konformitetit dhe Dokumentacionin Teknik të instrumentit matës;
- Të pajisin instrumentin me dokumentacionin metrologjik. (Librezën e instrumentave matës, raportet e testimit ose të verifikimeve, dhe shenjat përkatëse.)

B. Detyrimet e përdoruesve të instrumenteve matëse.

1. Personat juridik dhe fizik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, duhet të përdorin instrumente matës ligjërisht të kontrolluar, në mënyrë që të sigurojnë saktësinë e kërkuar të matjeve;
2. Ata janë përgjegjës për performancën teknike të instrumentave matës dhe për saktësinë e rezultateve të matjeve (Neni 20, i ligjit 9875 “Për Metrologjinë”);
3. Duhet të përdorin instrumenta matës të verifikuara;
4. Të mirëmbajnë ato në kushte teknike, që sigurojnë saktësinë e matjeve;
5. Të kryejnë verifikimet periodike të instrumentave matës sipas këtij ligji dhe rregullave të përshtatura për zbatimin e tij;
6. T’i përdorin sipas qëllimit të tyre;
7. Të mbajnë regjistrime për mirëmbajtjen dhe verifikimin e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara në përdorim, kur kështu është e përshkruar;
8. Të mbajnë dokumentacionin metrologjik të instrumentave matës.

(Neni 21, i ligjit nr. 9875, “Për metrologjinë”; VKM, nr. 770, “Për Instrumentat Matës”)





PARAPAKETIMI

1lte



II. PARAPAKETIMI

Detyrimet e prodhuesve dhe importuesve të parapaketimeve, shisheve dhe enëve matëse

1. Mallrat e paketuara dhe shisheet, si enë matëse, mund të hidhen në treg dhe të ofrohen për shitje, vetëm nëse plotësojnë kërkesat metrologjike të përshkruara dhe kanë mbishkrimet dhe shenjat e përshkruara deri në kohën e blerjes;
2. Prodhuesi, ose importuesi, është përgjegjës për përputhshmërinë e produkteve të paketuara dhe të shisheve;
3. Prodhuesi zbaton sistemin e tij të kontrollit të sasisë neto të paketimeve, ose sistemin e kontrollit të vëllimit neto të shisheve të prodhuara;
4. Prodhuesi ose importuesi, kur konstatohet se parapaketimet, ose shisheet enë matëse, të hedhura në treg prej tij nuk përmbushin kërkesat ligjore të përshkruara, është i detyruar që në bashkëpunim me inspektoratin, që mbulon fushën e metrologjisë, të marrë masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorit.

(Neni 37, i ligjit nr. 9875 “Për metrologjinë”; VKM, nr. 1352, “Rregullore për parapaketimet”; VKM, nr. 1161, “Rregullore për shisheet enë matëse”)



LODRAT



III. LODRAT

Operatorët ekonomik që tregtojnë artikuj të klasifikuar si 'lodër' në kuptim të Rregullit teknik (Prodhues/ Përfaqësues i Autorizuar, Importues, Shpërndarës), përpara hedhjes së lodrave në treg, duhet të sigurojnë që produkti:

1. Të mbajë Markimin CE të konformitetit.

Markimi CE duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e shtrua në Nenin 9 të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011;

2. Të shoqërohet nga Deklarata e Konformitetit (EC Declaration of Conformity).

Deklarata e Konformitetit duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në Nenin 8, Ligji nr. 10489, datë 15.12.2011;

3. Të shoqërohet nga Dokumentacioni teknik.

Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë vlerësimin e konformitetit të produktit me kërkesat ligjore në lidhje me të dhe duhet të përfshijë një analizë dhe vlerësim të përshtatshëm të risqeve;

4. Të shoqërohet nga Paralajmërimet.

Udhëzimet në (gjuhën shqipe) për përdorimin, si: moshë, kufizimet, etj., dhe për mirëmbajtjen;

5. Mban një numër tipi, grupi apo serie, ose elemente të tjera, që lejojnë identifikimin e tij; si dhe mban emrin prodhuesit, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën ku mund të kontaktohet.



DETERGJENTËT



IV. DETERGJENTËT

Operatorët ekonomik që tregtojnë artikuj që klasifikohen Detergjentë në kuptim të Ligjit nr. 10216, datë 21.01.2010, “Për Detergjentët” (Prodhues/ Përfaqësues i Autorizuar, Importues) duhet të sigurojnë përpara vendosjes së produktit në treg:

- 1. Informacionin për një, ose më shumë, rezultate të testeve për biodegradimin përfundimtar,**
përcaktuar në Nenin 9, pika 2, ligji “Për detergjentët”;
- 2. Dosjen teknike,**
përmbajtja e të cilës specifikohet në pikën 5 të VKM nr. 220, datë 28.03.2012 “Për përcaktimin e standardeve, metodave të testimit dhe kufijtë e lejuar për biodegradimin e detergjentëve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndet tensioaktive në Detergjentë”;
- 3. Duhet të plotësojnë kufijtë e lejuar për biodegradimin aerob**
përcaktuar në Nenin 4 pika 1 të Ligjit “Për Detergjentët”;
- 4. Të jetë i etiketuar dhe i paketuar**
në përputhje me VKM nr. 669, datë 28.09.2011 “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentët” dhe legjislacionin në fuqi mbi kimikatet.



VESHJET E KËMBËS



V. VESHJET E KËMBËS

Në zbatim të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe VKM nr. 222, datë 28.3.2012 “Për miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët”, **Operatorët Ekonomik sipas nivelit të përgjegjësisë, janë përgjegjës për sigurimin e etiketave dhe saktësinë e informacionit të dhënë në të.**

Etiketimi:

1. Duhet të jepet për

- Pjesën e sipërme,
- Veshjen e brendshme dhe astarin,
- Pjesën e poshtme

2. Duhet të jepet në të paktën një nga artikujt e veshjes së këmbës për çdo palë;

3. Duhet të jetë sipas përcaktimit në pikën 8, 9, 10, 15 të VKM-së nr. 222.



QELQI



VI. QELQI

Në zbatim të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe VKM nr. 221, datë 28.3.2012 “Për miratimin e rregullave teknike “Për etiketimin e produkteve të qelqit kristal”, **Operatorët Ekonomik**, të cilët tregtojnë produktet që mbulohen nga kreu nr. 7013 i Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, duhet të sigurojnë:

- **Përbërjen, karakteristikat e prodhimit dhe etiketimin e produkteve;**
- **Të gjitha format e publicitetit/reklamimit për këto produkte në përputhje me rregullin teknik.**



TEKSTILE



VII. TEKSTILET

Në zbatim të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe VKM nr. 1058, datë 23.12.2015, “Rregull Teknik “Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimi e markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile”, **operatorët ekonomik duhet të sigurojnë** që produktet që konsiderohen tekstile sipas kuptim të rregullit teknik:

- Janë etiketuar dhe markuar në mënyrë të tillë që të tregohet përbërja e fibrave të tyre (edhe me metër);
- Kanë përputhshmëri të përbërjes së fibrave të tyre, me informacionin e dhënë lidhur me përbërjen (analizë laboratorike);
- Janë të shoqëruara me dokumentet tregtare shoqëruese (kur u furnizohen operatorëve ekonomik, apo përgjigje për një porosi).



PRODUKTET ELEKTRISKE



VIII. PRODUKTET ELEKTRIKE

Në përputhje me legjislacionin përkatës, ligji nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe VKM 1061/2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit” çdo produkt elektrik duhet të shoqërohet nga elementët e mëposhtëm:

1. Të mbajë Markimin CE të konformitetit.

Markimi CE duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e shtruara në nenin 9 të ligjit nr. 10489 dhe simboli grafik i tij duhet të jetë sipas pikës 3.4 të VKM 1061/2015, Mbi Rregullin Teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit”;

2. Të shoqërohet nga Deklarata e Konformitetit (EC/EU Declaration of Conformity).

Deklarata e Konformitetit duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 8 ligji nr. 10489 datë 15.12.2011, ose me ato në pikën 5 të VKM 1061/2015;

3. Dokumentacioni teknik.

Prodhuesi harton dokumentacionin teknik. Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë vlerësimin e konformitetit të produktit me kërkesat ligjore në lidhje me të dhe duhet të përfshijë një analizë dhe vlerësim të përshtatshëm të riskut/risqeve. Dokumentacioni teknik dhe elementët që ai duhet të përfshijë janë të përcaktuara përkatësisht në nenin 8, pika 3, ligj nr. 68/2012 si dhe në VKM përkatëse sipas llojit të produkteve elektrike;

4. Shoqërohet nga udhëzimet për përdorimin, ose sipas rastit mirëmbajtjen, si dhe nga informacioni për sigurinë në gjuhën shqipe;

5. Mban një numër tipi, grupi apo serie, ose elemente të tjera që lejojnë identifikimin e tij, si dhe mban emrin e prodhuesit, emrin tregtar, ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën ku mund të kontaktohet.

6. Etiketa. Me etiketë janë të detyrueshme të shoqërohen vetëm produktet elektrike të përfshira si më poshtë:

- Furrat shtëpiake dhe aspiratorët thithës, pika 3, të VKM nr. 191/2018 dhe formati është i përcaktuar në pikën 8, të VKM nr. 191/2018,
- Kondicionerët e ajrit, pika 3, të VKM nr. 865/2015,
- Makinat larëse për përdorim shtëpiak, pika 3, të VKM nr. 928/2012,
- Pajisjet frigoriferike për përdorim shtëpiak, pika 3, të VKM nr. 929/2012,
- Tharëset për përdorim shtëpiak VKM nr. 296/2013,

7. Skeda informative. Me skedë është e detyrueshme të shoqërohen vetëm produktet elektrike të përfshira si më poshtë:

- Furrat shtëpiake dhe aspiratorët thithës, pika 3, të VKM nr. 191/2018 dhe formati është i përcaktuar në Pikën 9, të VKM nr. 191/2018,
- Kondicionerët e ajrit, pika 4, të VKM nr. 865/2015,
- Makinat larëse për përdorim shtëpiak, pika 4, të VKM nr. 928/2012,
- Pajisjet frigoriferike për përdorim shtëpiak, pika 4, të VKM nr. 929/2012,
- Tharëset për përdorim shtëpiak VKM nr. 296/2013.





ASHENSORËT



IX. ASHENSORËT

1. Personi përgjegjës i produktit/instalimit është i detyruar të regjistrojë çdo ashensor të ri ose ekzistues pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut (ISHMT), në bazë të nenit 16/2, të ligjit nr. 10489 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar datë 15.12.2011 dhe pikës 4, të VKM nr. 1056, datë 23.12.2015, Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”.

Personi përgjegjës që bën regjistrimin e një ashensori të ri duhet gjithashtu të bashkëngjisë në formatin e regjistrimit dhe **një kopje të deklaratës së konformitetit të ashensorit dhe të komponentëve të tij të sigurisë.**

2. Personi përgjegjës siguron që ashensori i nënshtrohet një ekzaminimi të plotë nga një organ i miratuar për këtë qëllim, në rastet e ashensorëve të montuar përpara datës 1 Janar 2010. Periudha ndërmjet dy ekzaminimeve të plota për ashensorët e instaluar në një vend pune nuk duhet të kalojë 6 vjet, ndërsa për ashensorët e instaluar në ndërtesa në bashkëpronësi, ose në ambiente shtëpiake nuk duhet të kalojë 10 vjet.

Ashensori u nënshtrohet inspektimeve periodike, ndërmjet ekzaminimeve të plota të njëpasnjëshme, nga një organ i miratuar në intervale kohore. Në rastin e ashensorëve ekzistues dhe të rinj të instaluar në një vend pune, inspektimet periodike kryhen një herë në çdo 6 muaj, duke respektuar datën e parë të vendosjes së tyre në shërbim. Në rastin e ashensorëve ekzistues dhe të rinj të instaluar në ndërtesa në bashkëpronësi, ose në ambiente shtëpiake, inspektimet periodike kryhen një herë në çdo 12 muaj.

(Pika 5.5.d, VKM nr. 1056, datë 23.12.2015, Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”)

3. Personi përgjegjës siguron që ashensori është i markuar qartësisht dhe në mënyrë të paqeshme me të dhënat e mëposhtme:

- Emrin dhe adresën e instaluesit (nëse nuk ekziston pronari i ndërtesës),
- Markimin CE (për ashensorët e rinj, ose ashensorët e instaluar pas datës 1 janar 2010),
- Emërtimin e serive ose tipin,
- Numrin serial (nëse ka),
- Vitin e instalimit,
- Të dhënat e personit që duhet kontaktuar në rast të një problemi.

4. Ashensorët e rinj, kur vendosen në treg, shoqërohen nga dokumentacioni përkatës, sikurse përcaktohet nga legjislacioni i veçantë për ashensorët, pra Deklarata EC e Konformitetit.

Detyrimet e prodhuesit

- Kur vendos në treg komponentët e tij të sigurisë për ashensorë, prodhuesi siguron se ata janë të projektuar dhe të prodhuar sipas legjislacionit në fuqi, duke plotësuar modulet e vlerësimit të konformitetit të kërkuar për markimin CE.
- Prodhuesi harton dokumentacionin e kërkuar teknik dhe kryen, ose ka kryer procedurën përkatëse të vlerësimit të konformitetit.
- Prodhuesi harton deklaratën EU të konformitetit. Siguron që ajo e shoqëron komponentin e sigurisë për ashensorë dhe vendos markimin CE.
- Prodhuesi mban dokumentacionin teknik, deklaratën EU të konformitetit dhe sipas rastit, vendimin/et e miratimit për 10 vjet pasi komponenti i sigurisë për ashensorë është vendosur në treg.

Detyrimet e Personit të autorizuar

Një prodhues, ose instalues, mund të zgjedhë një përfaqësues të autorizuar me një akt përfaqësimi.

- Përfaqësuesi i Autorizuar detyrohet që të mbajë deklaratën EU të konformitetit dhe, në rastin kur kërkohet, vendimin/et e miratimit të lidhura me sistemin e cilësisë së prodhuesit, ose instaluesit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të ISHMT-së për 10 vjet pasi komponenti i sigurisë për ashensorë është vendosur në treg.

Detyrimet e importuesit

- Importuesi, për një periudhë 10 vjeçare pasi komponenti i sigurisë për ashensorë është vendosur në treg, mban një kopje të deklaratës EU të konformitetit dhe sipas rastit, vendimin/et e miratimit, në dispozicion të ISHMT-së dhe siguron se dokumentacioni teknik mund të vihet në dispozicion sipas një kërkesë të bërë.

(Neni 16, pika 1, ligji nr. 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, VKM nr. 192, datë 04.04.2018, Për miratimin e rregullit teknik “Për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”)





PRONËSIA INDUSTRIALE DHE INTELEKTUALE

PATENTAT

DISENJOT INDUSTRIALE

MARKA TREGTARE

TREGUESIT GJEOGRAFIKË DHE EMËRTUESIT E ORIGJINËS

TË DREJTAT E AUTORIT

Detyrimet ligjore që duhet të përmbushin subjektet që operojnë në treg në zbatim të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale” i ndryshuar, të cilët si objekt të aktivitetit të tyre kanë:

- a) Patentat dhe modelet e përdorimit;
- b) Dizenjot industriale;
- c) Markat tregtare dhe të shërbimit;
- ç) Treguesit gjeografikë janë si më poshtë:

I. EFEKTET E PATENTËS DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE

Në zbatim të nenit 36 të ligjit për pronësinë industriale:

1. Kur një patentë ka të bëjë me një produkt, ose proces, palët e treta janë të detyruara të pajisen me autorizim nga pronari i patentës.
2. Asnjë palë nuk ka të drejtë të shesë, përdorë, ofrojë për shitje ose importojë produktin pa miratimin e pronarit, i cili ka regjistruar patentën.



#Design



John Doe

Jane Smith

Bob Brown

Color

low

II. EFEKTET E REGJISTRIMIT TË DISENJOS INDUSTRIALE DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE

Në zbatim të nenit 127 të ligjit të pronësisë industriale:

1. Disenjo industriale është një e drejtë ekskluzive e pronarit të disenjos industriale.
2. Çdo palë e tretë ndalohet të prodhojë, të ofrojë, të importojë, të eksportojë, të hedhë në treg, të furnizojë, të shpërndajë, të përdorë, ose të mbajë në ruajtje apo zotërim, për këto qëllime, çdo produkt, në të cilin është përfshirë disenjoja, ose mbi të cilin është aplikuar pa pëlqimin e tij.





III. EFEKTET E REGJISTRIMIT TË MARKËS TREGTARE DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE

Në zbatim të nenit 156 të ligjit të pronësisë industriale:

1. *Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të markës, si dhe të ndalojë personat e tretë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, të përdorin, pa autorizimin e tij:*
 - a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka;
 - b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë, apo ngjashmërisë së mallrave, ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare;
 - c) një shenjë të njëjtë, ose të ngjashme, për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë, ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës.





IV. EFEKTET E REGJISTRIMIT TË TREGUESVE GJEOGRAFIKË (TGJ) DHE EMËRTIMEVE TË ORIGINËS (EO) DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE

Në zbatim të nenit 178 të ligjit të pronësisë industriale:

- 1. E drejta e pronësisë mbi Treguesit Gjeografikë (TGJ) ose Emërtimeve të Originës (EO)** fitohet nëpërmjet regjistrimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI). Regjistrimi i një treguesi gjeografik u jep pronarëve të drejtën për ta përdorur atë. Ata nuk kanë të drejtë të japin licenca përdorimi për TGJ ose EO.
- 2. Referuar nenit 178 pronari ka të drejtë të ndalojë:**
 - a. Çdo përdorim tregtar të një treguesi gjeografik, ose emërtimeve të origjinës për mallrat që janë të njëjta, ose të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar treguesi gjeografik, ose emërtimeve të origjinës, ose çdo përdorim për mallrat, edhe kur ato nuk janë të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar treguesi gjeografik ose emërtimeve të origjinës, nëse nga reputacioni i mallrave, për të cilat është regjistruar treguesi gjeografik ose emërtimeve të origjinës, është arritur përfitim i padrejtë;
 - b. Çdo përdorim të papërshtatshëm, ose falsifikim të treguesve gjeografikë, ose emërtimeve të origjinës edhe nëse është specifikuar origjina e vërtetë e mallrave, ose çdo përdorim i përkthimit, ose përdorim i shoqëruar me terma të tillë si “lloj”, “tip”, “stil”, ose të tjera të ngjashme me to;
 - c. Çdo përdorim tjetër i pasaktë dhe i pavërtetë i treguesve gjeografikë ose emërtimeve të origjinës, i origjinës, natyrës ose cilësive thelbësore të mallrave të specifikuar në ambalazhim, në materialet e reklamimit dhe të korrespondencës për produktet, kur të dhëna të tilla shkaktojnë keqinformim për origjinën e vërtetë të produkteve;
 - d. Çdo përdorim të treguesve gjeografikë ose emërtimeve të origjinës, që identifikon verëra ose pije, që nuk e kanë origjinën në vendin e përcaktuar nga treguesi gjeografik, edhe në rastet kur jepet origjina e vërtetë e tyre, ose çdo përdorim i përkthimit, apo përdorim i shoqëruar me terma të tilla, si “lloj”, “tip” etj.;
 - e. Çdo veprim tjetër, që mund të shkaktojë keqinformim të përdoruesit për origjinën e vërtetë të mallrave.

Çdo cënim, apo mos respektim, i këtij Ligji, Ju bën subjekt të sanksioneve administrative të parashikuara!



V. TË DREJTAT E AUTORIT

Nëse shfrytëzoni, përdorni, tjetëroni për arsye tregtare, çdo veprimtari krijuese (vepër letrare, artistike ose shkencore) në territorin e Republikës së Shqipërisë, e cila mbrohet nga ligji i të drejtave të autorit, duhet të kenë kujdes të respektoni të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to:

- 1. Autor është çdo person fizik, ose një grup personash fizikë, që krijojnë:**
 - vepër letrare, artistike, shkencore (libër, pikturë, këngë, program kompjuterik, kinematografi, e të tjera);
 - produkt intelektual original dhe që mbart karakteristika individuale (tekstet akademike, librat shkollorë, koreografitë, e të tjera);
 - produkt të materializuar, pavarësisht nga forma dhe mënyra e të shprehurit (krijime arkitekturore dhe tri dimensionale, skulptura, e të tjera).
- 2. Autori gëzon të drejta ekskluzive vetjake jopasurore dhe ato pasurore.**
- 3. Çdo mënyrë e shfrytëzimit të origjinalit të një vepre, ose të kopjeve të saj, pa lejen e autorit/trashëgimitarit/ose personit të autorizuar prej tij, konsiderohet e paligjshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.**
- 4. Të drejtat e autorit mund të administrohen:**
 - veçmas në mënyrë individuale për çdo vepër të autorit;
 - bashkarisht në mënyrë kolektive, nëpërmjet agjencive të administrimit kolektiv, për një numër veprash të disa autorëve në të njëjtën kohë.
- 5. Administrimi kolektiv i të drejtave mund të kryhet nga agjencitë e administrimit kolektiv të të drejtave, të cilat:**
 - janë subjekt juridik, të krijuara nga mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura;
 - kanë për objekt të veprimtarisë mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave;
 - kryejnë shpërndarjen e të ardhurave të titullarët e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura;
 - duhet të marrin liçencimin nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit.
- 6. Agjencitë, që janë liçencuar nga Ministria e Kulturës për të administruar të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, përfaqësohen nga SUADA.**
 - e cila funksionon si sportel i vetëm, unik në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura;
 - ka për detyrë të kontaktojë, informojë, dhe mbledhë të ardhura nga subjektet përdorues të veprave;

7. Një person fizik ose juridik, para se të fillojë të përdorë një objekt të mbrojtur nga të drejtat e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, duhet të paraqesë në agjencinë e administrimit kolektiv kërkesën për autorizimin e këtij përdorimi.

- Kërkesa duhet të përmbajë informacion për llojin dhe rrethanat e përdorimit,
- Si mënyrën, vendin dhe kohën e përdorimit,
- Informacione të tjera të nevojshme për përcaktimin e shumës së shpërblimit.

8. Agjencia e administrimit kolektiv i jep përdoruesit autorizimin për shfrytëzimin e objektit të mbrojtjes brenda kompetencave të saj. Në autorizim përfshihen:

- Tregues të llojeve të të drejtave, për të cilat ai zbatohet,
- Kushtet e përdorimit për sa i përket mënyrës, vendit, kohës,
- Masës së shpërblimit për shfrytëzim,
- Ku përdorimi i nënshtrohet pagesës së shpërblimit.

Për më shumë informacion për rregullimin ligjor referojuni ligjit nr.35/2016, “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to”.

Çdo cënim, apo mos respektim i këtij Ligji, Ju bën subjekt të sanksioneve administrative të parashikuara!





Implemented by



REPUBLIKA E ALBANIËS
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË



ISHMT
Instituti Shqiptar i Shkencave dhe Teknologjive të Tregut
info@ishmt.gov.al
www.ishmt.gov.al

